



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 29 Korrik 2021

Nr: 438

VENDIM

PËR

**DEKLARIMIN TË PËRFUNDUAR PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS  
ADMINISTRATIVE TË SHOYRTIMIT TË REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË  
PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z.  
BOIKEN XHELAL ABAZI, KANDIDAT PËR DEPUTET I PROPOZUAR NGA  
ZGJEDHËSIT, QARKU TIRANË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR  
GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE  
USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”**

Sot më datë 29.07.2021, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Boiken Xhelal Abazi, kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

Palë të interesuara: z. Boiken Abazi, kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021

Baza ligjore: nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pika 12, e Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të



detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

## **VËREJ:**

### **I.**

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për deputet”.

Në zbatim të këtyre dispozitave", z. Boiken Xhelal Abazi, kandidat për deputet i propozuar nga Zgjedhësit, qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetdeklarimit me numër unik 13. Pas kërkesë së bërë për plotësime ka ridepozituar formularin e vetdeklarimit me numër unik 13/1.

Në bazë të kompetencave të veta, KQZ bëri verifikimin prima facie dhe ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1568 prot., datë 01.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 2228/1 prot., datë 04.03.2021, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për deputet, z. Boiken Xhelal Abazi, nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë në sistem, pra nuk është i dënuar.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1569 prot., datë 01.03.2021, ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 879/1 prot., datë 30.03.2021, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për deputet z. Boiken Xhelal Abazi, nuk rezulton të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 145 datë 16.03.2021, vendosi “Regjistrimin e z. Boiken Xhelal Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit për deputet, për zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

### **II.**

Për deklarimin e përfunduar dhe pa vendim përfundimtar të procedurës administrative të shqyrtimit të rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Boiken Xhelal Abazi, kandidat për deputet i propozuar nga Zgjedhësit, Qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015

Data: 29 Korrik 2021  
Nr. 438



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet z. Boiken Xhelal Abazi.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Boiken Xhelal Abazi, rezultoi se ka deklaruar:

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1: “A jeni dënuar ndonëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

- *“.....Siç e ka shpjeguar edhe në formularin e parë të dorëzuar në KQZ në datën 26 shkurt 2021, nuk ka informacion zyrtar nga autoritetet e Kosovës, edhe pse këtë gjë e ka kërkuar prej tyre. Por i gjithë aktiviteti i tij ka qenë publik në Kosovë dhe i lidhur me organizimet politike të Lëvizjes VETËVENDOSJE! Për shkak të shkresës së KQZ-së në Shqipëri, data 6 mars 2021, ku i është kërkuar të plotësojë këtë pjesë të formularit të dekriminalizimit pavarësisht mungesës së informacionit zyrtar nga autoritetet e Kosovës, atëherë në bazë të hulumtimit që ka bërë të raportimeve mediatike së tij, dhe diskutimit me kolegët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, subjekti vetëdeklarues deklaroi se më datë 17 tetor 2012, janë ndaluar nga Policia e Kosovës 62 aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! Për shkak të pjesëmarrjes në organizimin politik të Lëvizjes VETËVENDOSJE! ku kundërshtojë nënshkrimi i marrëveshjes për privatizimin e Kompanisë Publike të Kosovës për Distribucionin për Furnizim me Energji Elektrike. Mes aktivistëve të ndaluar nga policia ka qenë edhe z. Boiken Xhelal Abazi i cili ka bindjen se shumica e aktivistëve të ndaluar janë proceduar nga “Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë”. Në këtë rast z. Boiken Xhelal Abazi beson se e njëjta gjykatë e sipërpërmendur ka proceduar edhe rastin e tij bashkë me aktivistë të tjerë.*

Po këtu, pyetjes 2 “A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?”, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Jo” duke deklaruar se: “...në dijeninë e tij nuk është dënuar me burg në asnjë shtet ku ka jetuar apo që ka vizituar. E vetmja situatë e paqartë lidhet me Kosovën, për shkak të angazhimit të tij politik me Lëvizjen VETËVENDOSJE! në Kosovë, dhe për shkak se autoritetet e Kosovës kanë refuzuar që ti japin informacion zyrtar. Megjithatë z. Abazi e

viziton Kosovën rregullisht, publikisht dhe zyrtarisht, dhe nuk është njoftuar nga organet kompetente për raste të tilla”.

Po ashtu pyetjes se “ A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur duke deklaruar disa raste të cilat sipas tij kanë ndodhur vetëm për shkak të ativititetit të tij politik.

Duke analizuar përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe deklaramet e vetë subjektit në formular, sipas të cilave ai pohon ka disa ndalime dhe procedime penale, bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Kreun V, pika 2, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1658 prot., datë 03.03.2021 vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarameteve të bëra.

Me shkresën nr. 423/55 prot., datë 12.07.2021, Drejtorja e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin Boiken Xhelal Abazi”. Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë të indicieve apo të dhënave që do të justifikonin një verifikim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe pas kryerjes së gjithë verifikimeve të mundshme brenda vendit, i konsideron këto verifikime të plota bazuar në përcaktimet e nenit 8, pika 1,2 të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10,11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetdeklarues Z. Boiken Xhelal Abazi sipas të cilit konstatohet:

1. Nuk rezulton të ketë gjeneralitete të tjera në përbërsit e gjendjes civile, përveç atyre të deklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruar;
2. Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar, për kryerjen e ndonjë vepre penale;



3. Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim gjygjësor jopërfundimtar nga një autoritet gjygjësor shqiptar, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjygjësor të formës së prerë;
4. Rezulton të ketë qënë person i atribuar për kryerjen e veprës kundërvajtëse – sjellje arrogante, nga neni 4, par. 1 të Ligjit për rendin dhe Qetësinë Publike, në Çështjen penale me nr. 6776/2012, në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë, **e cila është pushuar me vendim gjykate;**
5. Rezulton të ketë qënë nga data 21.06.2016 person nën hetim për kryerjen e veprës penale “ Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi”, **procedim penal i cili është pushuar me vendim gjykate.**
6. Rezulton të ketë qënë nën hetim për kryerjen e veprave penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, “Organizim dhe pjesëmarrja në grumbullim e manifestime të paligjshme”, “Pengim i qarkullimit të mjeteve të transportit ’, për të cilin, Gjykata e Rrethit Gjygjësor Tiranë **ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të tij.**
7. Nuk rezulton të jetë lëshuar ndaj tij ndonjë urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
8. Rezulton të jetë dëbuar më 21.03.2016, në bazë të “ Urdhër Largimi me Forcë” lëshuar më datë 16.03.2016 nga Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës, Drejtoria për Migrimin dhe të Huaj, dhe ti jetë ndaluar hyrja për 2 vite në territorin e Republikës së Kosovës.

### III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

- a) z. Boiken Xhelal Abazi, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, qarku Tiranë, nuk përfitoi mandat dhe në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, as në të ardhmen nuk do të mund të përfitojë mandatin e deputetit për këtë legjislaturë. Në këto kushte, në zbatim të nenit 10 të ligjit 138/2015, vlerëson se ka humbur objekti dhe qëllimi i verifikimit të thelluar, për sa kohë ky subjekt nuk do të mund të përfitojë mandatin e deputetit, rast për të cilin autoriteti përgjegjës, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të shprehet paraprakisht nëse subjekti është apo jo në kushtet e ndalimit,



- b) Bazuar në pikat 2 e 3, të nenit 90, dhe në nenin 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, është në diskrecionin e organit kompetent të deklarojë të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikën 12 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

### **V E N D O S:**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative pa vendim përfundimtar, për shkak se është bërë i pamundur objekti dhe qëllimi për të cilin ka nisur procedura e verifikimit për subjektin vetdeklarues z. Boiken Xhelal Abazi, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”.
2. z. Boiken Xhelal Abazi, të njhet me vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme, “Për miratimin e rezultateve të verifikimit”, për të.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetëditëve) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 29 Korrik 2021  
Nr. 438

Për deklarimin e përfunduar dhe pa vendim përfundimtar të procedurës administrative të shqyrtimit të rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetdeklarues z. Boiken Xhelal Abazi, kandidat për deputet i propozuar nga Zgjedhësit, Qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015